



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
 AGJENCIA ZA SPRJEÇAVANJE KORUPCIE
 THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 06.03.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-2074/22, për zyrtarin e lartë z. Sadik Berisha, ish Anëtar i Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

| | |
|--|-----------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGJENCIA ZA SPRJEÇAVANJE KORUPCIE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION | |
| Dep. | Nr.Prot. |
| Dep. 06 | Pr.Prot. 381/23 |
| Nr. Faq. | Data |
| Br. Str. | Datum |
| Nr. Page. 02 | Date 10.03.2023 |

A r s y e t i m

1. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pas pranimit të kërkesës nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar, me të cilin është kërkuar interpretim lidhur me atë se z. Sadik Berisha, krahas ushtrimit të funksionit publik “Anëtar i Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, si përfaqësues nga Oda Ekonomike njëkohësisht është Auditor Ligjor dhe partner në RSM Kosovo Sh.P.K” dhe RSM Albania Sh.P.K, i angazhuar në menaxhimin e projekteve të ndryshme të auditimit taksave dhe konsulences..

Zyrtari i lartë z. Sadiku, është certifikuar Auditor Ligjor në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 06/L-032 si dhe UA nr.2019/01 nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar. Mbajtësit të kësaj certifikate i jepen të gjitha të drejtat për të kryer Auditime siç parashihet me Ligj dhe mban titullin “Auditor Ligjor”. Zyrtari i lartë z. Berisha është bashkëpronar dhe përfaqësues i autorizuar në biznesin privat “RSM KOSOVO SH.P.K” i licencuar si firmë e jashtme ligjore Auditimi në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr.04/L-014, si dhe UA nr.2016/1. Mbajtësit të kësaj licence i jepen të gjitha të drejtat për të kryer Auditime siç parashihet me Ligj.

Kryesuesi dhe anëtarët e KKRF-së propozohen nga institucionet përkatëse sipas paragrafit 1 të nenit 21 dhe emërohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për një mandat tre (3) vjeçar, me të drejtë të ri emërimit edhe për një mandat tjetër.

Ligji nr.06/L-032 për Raportim Financiar, Kontabilitet dhe Auditim, ka përcaktuar kushtet e licencimit të Auditorëve, firmave të huaja dhe vendore të Auditimit.

Agjencia, lidhur me këtë rast ka mbajtur një takim me zyrtarin e lartë, gjatë këtij takimi z. Berisha është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik nuk mund të ushtroj veprimtari profesionale si ekspert i licensuar sepse kjo ndalohej me nenin 12 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në të cilin shprehimisht thuhet;

Kufizimi i zyrtarit të lartë në ushtrimin e veprimtarive të tjera krahas ushtrimit të funksionit publik

1. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licensuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.

2. Në kuptim të këtij neni, veprimtari profesionale nënkuptojnë veprimtaritë për të cilat kërkohet licencim sipas ligjit në fuqi.

Zyrtari i lartë z. Berisha, gjatë takimit të mbajtur është deklaruar se do të ofroj dorëheqje nga funksioni i Anëtarit të Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, në mënyrë që të shmanget gjendje e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare nr.(06-287-23), me të cilën dëshmohej se zyrtari i lartë z. Berisha ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit Anëtar i Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit